

Laura Pruthi (Lipoveci)

Ilir Kuka

SHKATHTËSI PËR JETË

1



Laura Pruthi (Lipoveci)

Ilir Kuka

SHKATHTËSI PËR JETË

1



BOTIME

pegi

Laura Pruthi (Lipoveci)

Ilir Kuka

SHKATHTËSI PËR JETË

Për klasën e parë të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Prishtinë, 2019

BOTIME



Drejtoi botimin: Valmira MUSHI
Recensentë të MASHT-së: Dr. Sabrije OSMANAJ,
Merita ZEQRIRI (HAJRIZI), Shkëndija JASHARI, Blerta BYTYCI
Redaktore letrare: Erina ÇOKU
Paraqitja grafike: Suela NINI
Kopertina: Enkeleda REXHA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-786-10-2

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, shtator 2019

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi sh.p.k. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Përmbajtje

1. MJEDISI

1.1	Ne kujdesemi për gjithçka që na rrethon	6
1.2	Mbrojtja e mjedisit	8
1.3	Unë kujdesem për mjedisin ku jetoj	10
1.4-5	Si t'i riciklojmë materialet	12
1.6	Kontrollo përparimin tënd	14

2. KUJDESI PËR MJEDISIN DHE RUAJTJA E SHËNDETIT

2.1	Higjiena ime	16
2.2	Kujdesi për higjienën në shtëpi dhe në shkollë	18
2.3	Unë ndihmoj në pastrimin e shtëpisë ose të shkollës	20
2.4-5	Krijoj modele të ndryshme	22
	Test 1	24

3. TRAFIKU

3.1	Siguria në rrugë	26
3.2	Shenjat e qarkullimit rrugor	28
3.3	Zbatimi i rregullave të qarkullimit rrugor	30
3.4-5	Çfarë më bën qytetar	32

4. MATERIALET DHE PËRPUNIMI I TYRE

4.1	Përdorimi i materialeve në jetën e përditshme	34
4.2	Klasifikimi i materialeve	36
4.3	Përdorimi i veglave të punës në jetën e përditshme	38
4.4-5	Krijoj objekte të thjeshta për shtëpi ose klasë	40
4.6	Kontrollo përparimin tënd	42
	Test 2	43

5. PROFESIONET

5.1	Profesionet e familjarëve të mi	44
5.2	Kur të rritem, dua të bëhem...	46
5.3	Profesionet që njoh	48
5.4	Vizatojmë mjete pune të profesioneve të ndryshme	49
5.5	Mësoj më shumë për llojet e profesioneve	50
5.6-7	Profesioni që më pëlqen më shumë	52



6. PLANIFIKIMI

6.1	Dita ime	54
6.2	Përgatitemi për festat	57
6.3	Kur bashkëpunojmë, festojmë edhe më bukur	59
6.4-5	Përgatitim postera dhe zbukurime për festat	61
	Test 3	64

UNË DI

Unë quhem _____.

Unë di të _____.



Vizato çfarë të pëlqen më shumë



Ne kujdesemi për gjithçka që na rrethon



Unë banoj në një shtëpi private. Ajo është dykatëshe dhe me oborr.

Është e ndërtuar me tulla dhe me material prej druri.



Kur u prish karrigia, babai e rregulloi me veglat që ka në shtëpi. Unë i qëndrova pranë për ta ndihmuar.



Pyet shokun ose shoqen e bankës:

A ndihmon për të rregulluar objektet në shtëpi?



Tavolina në kuzhinë është prej druri, ndërsa ajo në oborr është plastike.

Divanet janë me veshje tekstili ose prej lëkure, sepse pastrohen më lehtë.



Në shkollë, bankat dhe dera e klasës janë prej druri.



DISKUTO NË KLASË

1. Prej çfarë materialesh janë objektet që keni në shtëpi?
2. Përshkruaj njërin material, që ta zbulojnë shokët/shoqet në klasë.

Veprimtari

Vendos numrin që tregon llojin e materialit.

1. DRU

2. PLASTIKË

3. LËKURË

4. TEKSTIL



Fjalë
të reja:

specialist – ai që ka njohuri shumë të mira në një fushë të caktuar.

1.2

Mbrojtja e mjedisit

Objektet apo orenditë që përdorim, janë prodhuar me materiale të ndryshme. Disa prej tyre ripërdoren, disa jo.



Kur bie suvaja e murit, për riparimin e saj përdoret llaçi. Këtë punë e bën muratori.




Materialet e ndërtimit riciklohen

Objektet prej druri mund të riparohen dhe të duken si të reja.



Kur i lyejmë me bojë ose me llak, ato jetojnë më gjatë.

Disa nga ushqimet dhe lëngjet janë me ambalazh kartoni, qelqi, metali ose plastike. Kur janë të riciklueshme, ato kanë shenjë 



Materiale të riciklueshme janë:



Materiale të pariciklueshme janë:



**Kuti të plastifikuara
ose me veshje alumini**



**Shishe plastike
pa shenjën PET**



Letër karboni



Letër higjenike



DISKUTO NË KLASË

1. Si ndikon përdorimi i materialeve të riciklueshme në mbrojtjen e mjedisit? Pse?
2. A tregojnë kujdes të gjithë fëmijët për mbrojtjen e mjedisit? Pse?



**Fjalë
të reja:**

llaç - lëndë ndërtimi, që përgatitet duke përzier rërën me gëlqere dhe me ujë.

suva - shtresë prej llaçi, që i vihet përsipër murit dhe tavanit.

Unë kujdesem për mjedisin ku jetoj

Unë dua të jetoj në një mjedis të pastër.



Në shtëpi, secili nga ne ndihmon për të pasur rregull dhe pastërti. Mbeturinat i hedhim në vendin e caktuar.



Në lagjen time, të gjithë ndihmojmë për ta mbajtur pastër atë.



Dalim dhe mbledhim mbeturinat në rrugë.



Ato janë hedhur nga persona që nuk tregojnë kujdes për mjedisin ku jetojmë.

Duke ricikluar materialet:

- zvogëlohet sasia e mbeturinave dhe ndotja e mjedisit;
- kursejmë burimet natyrore dhe energjinë.



Pastrojmë oborrin e shkollës. Mbeturinat i hedhim në kosha të caktuar, sipas llojit të materialeve.



Jo vetëm që pastrojmë, por edhe kujdesemi të shtojmë gjelbërimin duke mbjellë bimë të reja.



Makina i çon mbeturinat në vendet e caktuara.



Për të mbajtur pastër mjedisin e shkollës. Pastrojmë çdo ditë klasën ku bëjmë mësim.

Vepra me përgjegjësi

Kur shikon që në shtëpi, lagje ose shkollë i hedhin mbeturinat vend e pavend, si vepron ti?

Diskuto me shokun ose shoqen

Si duhet të vepronim për ta mbajtur pastër mjedisin?



1.4-5

Si t'i riciklojmë materialet

Unë dua të ricikloj objektet që nuk i përdor. Kështu do të jem i dobishëm për komunitetin ku jetoj.

Riciklojmë së bashku duke ndjekur modelet e mëposhtme:



Me gomat që nuk përdoren më, mund të bëjmë një kopsht shumë të bukur.



Me kavanozat mund të bëjmë vazo për lulet ose për bimët bujqësore.



Me shishet plastike mund të bëjmë vazo për lulet.

Zgjedh modelin që më pëlqen të krijoj me materiale të riciklueshme.

Me tubin prej kartoni ku mbështillet letra e kuzhinës, bëj një mbajtëse lapsash. Cili nga modelet në figurë të pëlqen më shumë?



Tani ti mund të ripërdorësh edhe objekte të tjera për të krijuar projektet e matematikës.



Diskuto me shokun ose shoqen

- Krahaso punimin tënd me atë të shokut ose shoqes së bankës.
- Kush e ka bërë më të bukur?



Kontrollo përparimin tënd

1.6

1 Shiko me vëmendje figurat. Në cilën prej tyre tregohet kujdes për mjedisin? Shëno ✓ brenda kutizave.



2 Jep mendimin tënd rreth figurës së mëposhtme.



3 Qarko materialet që mund të riciklohen.



4 Çfarë po bën vajza në figurë? A do të veproje edhe ti në të njëjtën mënyrë? Pse?



Ripërdoret

*Plastikë
e ripunueshme*

*Letër
e riciklueshme*



redukto - përdor sa më pak.

2.1

Higjiena ime

Çdo mëngjes, pasi çohem nga shtrati, unë **laj duart dhe fytyrën**.
Larja largon mikrobet.



Laj dhëmbët, që të mos prishen dhe goja të mos mbajë erë të keqe.



Kreh flokët, që të jem i/e rregullt.



Vishem vetë ose me ndihmën e më të rriturve.



Lidh këpucët dhe bëhem gati për në shkollë.



Kjo është një nga ditët e mia të zakonshme.



PYET SHOKUN OSE SHOQEN E BANKËS:

A vepron kështu si ti?

Përshkruaj veprimet që kryen vajza në figurë. Kështu vepron edhe ti?
Trego çfarë veprimi kryen tjetër në mëngjes.



Në figurë janë paraqitur mjetet kryesore të higjienës personale.
Cilat prej tyre i përdor vetë, pa ndihmën e më të rriturve?



Mjetet e higjienës personale na ndihmojnë të jemi të pastër dhe të rregullt.
Diskutoni me njëri-tjetrin për rëndësinë e përdorimit të tyre.

2.2


Kujdesi për higjienën në shtëpi dhe në shkollë

Pastërtia dhe rregulli janë të rëndësishme në çdo mjedis ku kryej veprimtaritë e mia. Të gjithë anëtarët e familjes sime kujdesen që ta mbajnë të pastër dhe të rregullt mjedisin ku banojmë.

A të pëlqen kuzhina në figurën djathtas? Pse?




Si mendon, a është mirë që dhoma e gjumit të jetë e çrregullt? Pse? Po ti, si kujdesesh për ta mbajtur të rregullt dhomën tënde?





Në shkollë mësojmë dhe argëtohemi. Të gjithë punojmë që ta mbajmë të pastër dhe të rregullt.

Një mjedis i pastër është i shëndetshëm për secilin prej nesh.



Të gjithë duhet të kujdesemi për shtimin dhe ruajtjen e gjelbërimit në lagje dhe në shkollë.



DISKUTO NË KLASË

Çfarë duhet të bëjmë për ta mbajtur të pastër dhe të rregullt mjedisin e shkollës?

2.3

Unë ndihmoj në pastrimin e shtëpisë ose të shkollës

Më pëlqen që mjedisi ku jetoj, të jetë përherë i pastër dhe i rregullt.
Çdo mëngjes, secili nga ne rregullon shtratin e tij, palos pizhamet dhe i vendos në vendin e caktuar.



Objektet që nuk i përdorim më, quhen **mbetje**. Shumica e tyre janë të riciklueshme.

Cilat nga këto mjete të pastrimit përdoren në shtëpinë tënde?
Vendos numrin përkatës brenda rrethit.

1	Fshesa ose furça për pastrimin e dyshemesë
2	Lopata e mbeturinave
3	Dorezat plastike
4	Kova
5	Sfungjeri
6	Lecka e pluhurave
7	Lecka për të larë dyshemenë
8	Detergjenti



Mësuesi/ja na porosit ta mbajmë klasën të pastër dhe të rregullt.
Ngjyros secilën figurë sipas veprimit që kryhet.

- ✓ Unë fshij dyshemënë e klasës.
- ✓ Rregulloj librat e mi.
- ✓ Fshij pluhurat e bankës.
- ✓ Mbledh letrat dhe i hedh në koshin e mbeturinave.



JEP MENDIMIN TËND

Shiko me vëmendje figurat. Shëno me ✓ veprimin e duhur dhe me ✗ veprimin e gabuar.







2.4-5

Krijoj modele të ndryshme

Mjetet e nevojshme: fletë vizatimi, fletë me ngjyra, karton, lapsa me ngjyra, lidhëse, ngjitëse, plastelinë me ngjyra, modele ilustruese.
A dëshiron t'i bësh atletet e tua më të bukura?
Vepru sipas modelit që paraqitet në figurë.



Pamjen e modelit mund ta ndryshosh sipas dëshirës ose duke krijuar vetë një model. Krahasoje me shokun ose shoqen e bankës.

Krijo modele me plastelinë

Zgjidh njërin nga modelet në figurë dhe puno së bashku me shokun ose shoqen e bankës për të krijuar një të tillë.



DISKUTO NË KLASË

Bëni një konkurs në klasë. Cilin punim u pëlqen më shumë shokëve dhe shoqeve? Pse?

TEST



1

Shëno pohimin e duhur me në kutizë.

Kur objektet dëmtohen, i hedhim në koshin e mbeturinave.

Kur objektet dëmtohen, i rregullojmë.

Karriget prodhohen vetëm me material druri.

Karriget prodhohen me disa lloje materialesh.

Shtëpitë ndërtohen vetëm me tulla.

Shtëpitë ndërtohen me disa lloje materialesh.



Unë i hedh të gjitha mbetjet në një kosh.

Unë i hedh mbetjet në kosha të veçantë (të ndarë).

Për ta mbajtur klasën të pastër, kujdesen vetëm punonjësit e shkollës.

Për ta mbajtur klasën të pastër, kujdesen punonjësit dhe nxënësit.

Ricikloj objekte prej materialesh të ndryshme.

Nuk ricikloj asnjë objekt, sepse i blej të reja.

- Ushqimet që ble, i fus në qese plastike.
- Ushqimet që ble, i fus në qese të riciklueshme.

- Çdo mëngjes i lidh vetë këpucët.
- Këpucët m'i lidhin vetë pjesëtarët e familjes.



- Çdo mëngjes bëj gjimnastikë.
- Një herë në muaj bëj gjimnastikë.

Shëno me ✓ materialet që riciklohen.

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
letër	qelq	gotë plastike	dru
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
alumin	mbështjellëse barnash	letër karboni	plastikë

3.1

Siguria në rrugë



Rrugës për në shkollë, tregoj kujdes kur eci.



Respektoj rregullat e qarkullimit rrugor.



Pres që semafori të ndezë dritën e gjelbër.



Eci në vijat e bardha.

Kur në rrugë kalojnë shumë makina, i kërkoj policit rrugor të më ndihmojë të eci në vijat e bardha.



Ndihmoj të moshuarit
që të kalojnë rrugën.



Nuk luaj asnjëherë në rrugë,
sepse mund të rrezikoj jetën.

Kur në rrugë mungojnë vijat e
bardha, sigurohem që nuk ka
makina, pastaj kaloj.



DISKUTO NË KLASË

- Si duhet të veprojmë, që të jemi të sigurt kur ecim në rrugë?
- Pse duhet të kërkojmë ndihmë, kur në rrugë lëvizin shumë makina dhe ne nuk mund të kalojmë?

3.2

Shenjat e qarkullimit rrugor

Në rrugë lëvizin makinat, biçikletat dhe këmbësorët.
Për lëvizjen e tyre janë përcaktuar shenja dalluese të veçanta.



Unë eci në vijat e bardha.



Rrugët për makinat janë me një, dy ose më shumë kalime.



Makinat lëvizin midis dy vijave të bardha.



Rrugët ku lëvizin biçikletat janë të ndara nga ato të makinave.
Për lëvizjen e tyre ndihmojnë shenjat dalluese rrugore.

Unë njoh disa nga shenjat e qarkullimit rrugor, që më ndihmojnë të eci i sigurt.

KUJDES!

Kalojnë




këmbësorë



fëmijë dhe të moshuar



biçikleta



Shenjat e rrezikut janë gjithmonë me ngjyrë **të kuqe**.



Shiko me vëmendje figurën. Çfarë shenjash dallon?
Cilat prej tyre duhet të respektosh?



DISKUTO NË KLASË

1. Pse duhet t'i zbatosh rregullat e qarkullimit rrugor?
2. Përshkruaj se çfarë duhet të kesh parasysh kur ecën në rrugë.

3.3

Zbatimi i rregullave të qarkullimit rrugor

Çfarë do të thotë secili nga sinjalet e semaforit? Shkruaji më poshtë ato.



Çfarë tregojnë këto sinjale?



.....

Shiko me vëmendje figurat. Si mendon, kush i zbaton rregullat e qarkullimit rrugor?

1



2



3






3.4-5

Çfarë më bën qytetar

Unë i respektoj punonjësit e policisë rrugore.
Kur në rrugë lëvizin shumë makina, punonjësi i policisë më ndihmon të kaloj.



1 Ngjyros shenjat e qarkullimit rrugor. Çfarë tregon secila prej tyre?



2 Krijë në klasë modele të vogla të sinjaleve rrugore.
Mjetet e nevojshme: karton, lapsa me ngjyra, gërshërë,
kapakë kavanozash, makina lodër, plastelinë.

3 Paraqiti punimet e tua në klasë.



4 Ndahuni në grupe dyshe dhe së bashku me mësuesin/en bëni një konkurs: "Si duhet t'i respektojmë rregullat e qarkullimit rrugor?".



5 Zgjidhni grupin fitues. Argumentoni zgjedhjen tuaj.

4.1

Përdorimi i materialeve në jetën e përditshme

Objektet që kemi në shtëpi janë prodhuar nga materiale të ndryshme. Ato kanë forma dhe ngjyra të shumëllojshme.



Materialet e tyre janë: druri, plastika, metali, kashta, qelqi.

Enët e gatimit janë prej metali, guri dhe qelqi. Ato e durojnë nxehtësinë.



Pjatat dhe gotat janë prej porcelani, qelqi ose plastike.



1 Qarko materialet plastike në figurën e mësipërmen.

Qelqi dhe porcelani janë materiale të përshtatshme për enë kuzhine, por thyhen lehtë.



Kujdes, kur thyehen objektet prej qelqi/porcelani !

Disa ushqime janë të ambalazuara në shishe qelqi ose plastike, kavanoza, kuti kartoni të plastifikuar etj.



Vazot e luleve që kemi në shtëpi, janë prej qeramike ose plastike.



DISKUTO NË KLASË

1. Shiko me vëmendje objektet e paraqitura në fotografinë e mëposhtme. Përcakto llojin e materialit të një objekti në kuzhinë.



Fjalë të reja:

porcelan - lëndë e bardhë, e shkëlqyeshme, që nuk e thith ujin dhe që përgatitet nga një lloj argjile.

Materialet kanë veti dhe pamje të ndryshme.

Ato i ndajmë në: metale dhe jometale.

Metalet që përdoren për prodhimin e objekteve të ndryshme janë: alumini, çeliku, inoksi, ari. Në shtëpinë tme kam objekte prej metali, si: gozhdë, vida, thekëse buke, makinë larëse, vegla pune etj.



Metali është i fortë dhe i qëndrueshëm. Disa metale kanë ngjyrë gri ose të bardhë, disa të tjera kanë ngjyrë të verdhë ose të kuqe.

Thekësja e bukës është zakonisht prej inoksi. Ajo është e veshur me plastikë, që të mos digjemi.



Disa ushqime dhe pije kanë ambalazh metalik prej alumini.

Ari është metal me ngjyrë të verdhë, i butë. Bizhuteritë në figurë janë prej ari.



Jometale janë: druri, qelqi, qeramika, materialet e ndërtimit (tulla, llaçi, boja) etj.



Karriget prej druri janë më të forta, të rehatshme dhe estetike. Karriget plastike janë më të lehta se ato prej druri dhe e durojnë diellin e lagështinë.



Dyert e shtëpisë sime janë prej druri. Porta e jashtme është prej metali, që të durojë shiun dhe diellin.



Dritaret janë prej druri dhe me xham të tejdukshëm.



Pllakat dhe pajisjet e bardha të banjës janë prej qeramike.



Qelqi dhe qeramika janë të fortë, por të thyeshëm.



DISKUTO NË KLASË

1. Pse veglat e punës janë prej metali?
2. Cila është arsyeja që ushqimet ambalazhohen në kuti metalike?



Fjalë të reja:

estetike - të bukura.

ambalazhoj - mbështjell me letër, karton, pëlhurë, ose fus në vazo a shishe ushqime që të mos dëmtohen.


çelik - metal i fortë, me ngjyrë hiri në të argjendtë.

4.3

Përdorimi i veglave të punës në jetën e përditshme

Në shtëpi kemi një kuti me vegla. Ato i përdorim për të rregulluar objekte të ndryshme. Mua më pëlqen t'i rri pranë dhe ta ndihmoj kur ai punon.

Unë njoh disa prej veglave.



Çekiçi mbërthen gozhdë.



Kaçavida vidhos vida.



Çelësi papagall përdoret për të vidhosur dado.



Sharra përdoret për të sharruar dru ose dërrasa.



Pinca përdoret për të kapur ose për të shtrënguar diçka, për të shkukur gozhdë etj.

Ndonjëherë, babai përdor trapanin elektrik të dorës për të hapur vrima në dërrasë ose në mur.

Nuk duhet ta prek trapanin, sepse mund të vritem.



Kur defekti është i rëndë, lajmërojmë punëtorin specialist.



DISKUTO NË KLASË

Cilat nga këto vegla pune njeh?



vidhos – fut ose shtrëngoj diku një vidë.
defekt – nuk punon.
përvojë – të gjitha njohuritë që fitohen në jetë ose në punë.



4.4-5

Krijoj objekte të thjeshta për shtëpi ose klasë

Unë kam dëshirë të krijoj një objekt. Do të bëj një mbajtëse lapsash ose vazo lulesh për në klasë.



Mjetet që do të përdor: fletë letre/kartoni A4, fletë me ngjyra, gërshërë, ngjitës, lapsa me ngjyra, gota/pjata plastike, shkopinj akulloresh.

Shoqja ime e bankës do të bëjë një qenush.



Unë do të krijoj një makinë larëse. Mjetet që do të përdor: fletë A4, karton, lapsa me ngjyra, gërshërë, pjatë plastike (njëpërdorimshe). Në fillim vizatoj formën e makinës larëse dhe butonat e saj, pastaj veproj si në figurë.



Shoku im i klasës do të krijojë një abazhur.

Mjetet që ai do të përdorë:

letër A4, karton me ngjyra, gërshërë,
lapsa me ngjyra, gota plastike.



Krahasoj punimet e mia me ato të shokëve të klasës.



Diskutojmë së bashku për punën e kryer.



JEP MENDIMIN TËND

1. Cili punim të pëlqen më shumë? Pse?
2. Rendit/trego materialet që ke përdorur.
3. Trego hapat që ndoqe për të krijuar punimin tënd.



Kontrollo përparimin tënd

4.6

1 Emërto veglat e punës.



2 Me çfarë materialesh janë prodhuar këto objekte?



3 Emërto shenjat e qarkullimit rrugor.



TEST



2

1 Shkruaj çfarë tregon secila nga shenjat e qarkullimit rrugor.



3 pikë

Kujdes!

Shenjat me ngjyrë **blu** e lejojnë lëvizjen. Shenjat me **të kuqe** nuk e lejojnë lëvizjen.

2 Në klasë ka objekte prej materialesh të ndryshme.

5 pikë

Shkruaj emrin e materialit të secilit prej objekteve të mëposhtme.

dritare

bankë

çanta e shkollës

libër

xhami i dritares



3 Emërto veglat e paraqitura më poshtë.

4 pikë



Pikë	1-3	4-6	7-9	10-12
Vlerësimi	☹️	😊	★	🚩

Në familjen time është traditë që profesionet të trashëgohen brez pas brezi. Gjyshi im ka qenë elektrikist. Këtë profesion ka edhe babai.

Ai rregullon rrjetin elektrik të ndërtesave.



Nëna ime është infermiere. Ajo u shërben të sëmurëve.



Xhaxhai punon hidraulik. Ai rregullon tubat e ujit kur pikojnë.



Halla ime është dentiste.

Tezja ime është mësuese.
Ajo i mëson nxënësit me durim e dashuri.



Ka edhe shumë profesione të tjera, ku punojnë të afërmit e mi.

Mjekët shërojnë shumë sëmundje.



Avokati është përfaqësues
ligjor, që mbron të drejtat
e njeriut.



Ekonomisti punon në bankë
dhe në ndërmarrje të ndryshme.

Muzikantët na kënaqin me atmosferën
festive që krijojnë me meloditë e tyre.



Unë e kam të vështirë të zgjedh një profesion, sepse të gjitha janë të bukura.



DISKUTO NË KLASË

Diskuto me shokun ose shoqen e bankës se çfarë do të bëheni kur të rriteni.



Unë kam dëshirë të mësoj sa më shumë, që kur të rritem, të zgjedh një profesion të bukur.



Unë dua të bëhem inxhinierë. Të ndërtoj rrugë më të mira dhe të sigurta.



Po sikur të bëhem bankiere, që të kujdesem për ekonominë e qytetarëve?



Apo arkitekte, që të projektoj ndërtesa të bukura dhe të forta?



Unë dua të bëhem murator, që të ndërtoj/riparoj shtëpi.



Po sikur të bëhem marangoz, që të bëj mobilie të bukura?



Ndoshta duhet të bëhem mjek,
që të shëroj të sëmurët.

Eh, sa shumë profesione, por unë nuk mund të vendos dot tani.
Kur të rritem, do të zgjedh profesion e duhur.



Tani duhet të mësoj shumë mirë të gjitha lëndët që kemi në shkollë.

Profesionet që njoh

1 Shiko me vëmendje figurat. A e përcakton dot profesionin që tregon secila prej tyre?



- 2 A ke ndonjë të afërm që punon në këto profesione?
- 3 Pyet shokun ose shoqen e bankës se cilin nga këto profesione njeh.
- 4 A punon ndonjë nga të afërmit e tij ose të saj në këto profesione?
- 5 A janë të kënaqur me punën që bëjnë?



5.4

Vizatojmë mjete pune të profesioneve të ndryshme

Për të vizatuar përdor këto mjete:




1 Vizato veglat e punës së marangozit.




2 Vizato veglat e punës së hidraulikut.



3 Vizato pajisjet e mjekut.



4 Vizato veglat e punës së bujkut.



5.5


Mësoj më shumë për llojet e profesioneve

Mësuesja na ka dhënë detyrë që, me ndihmën e prindërve, të kërkojmë për to në internet.

Ndeza kompjuterin dhe klikova mbi shenjën e internetit.



Pastaj shkrova adresën: <https://www.google.al/>



Në faqen që m'u hap, shkrova: **profesioni i mjekut** dhe klikova

Enter


Google

profesioni i mjekut




Sa shumë informacione kishte për këtë profesion! Unë zgjodha vetëm njërin prej tyre, duke klikuar me miushin (mausin).

Për të gjetur fotografi, klikova tek imazhet (*images*).



Në internet mund të gjejmë informacione edhe për shumë profesione të tjera. Aty mund të gjejmë gjithashtu adresa dhe numra telefoni për shërbimet që mundëson secili prej tyre.



DISKUTO NË KLASË

1. Po shoku ose shoqja e bankës, a ka kërkuar informacione në internet?
2. E ka kryer vetë kërkimin, apo me ndihmën e më të rriturve?



5.6-7






Profesioni që më pëlqen më shumë

Sot në klasë do të diskutojmë për profesionet që njohim. Unë kam gjetur në internet disa fotografi që tregojnë profesione dhe mjetet që përdoren në secilin prej tyre. Kështu si unë kanë vepruar edhe shokët e shoqet e klasës.



Së bashku do të diskutojmë për rëndësinë që kanë këto profesione në jetën e përditshme.

1 Vizatoj veten time në profesionin që më pëlqen më shumë.



2 Diskutoj me shokun ose me shoqen e bankës për vizatimin që bëra.



3 Mua më pëlqen të bëhem
Shokut/shoqes sime i pëlqen të bëhet

Dita ime

Më pëlqen të jem i/e rregullt. Dua që çdo veprim ta bëj në kohën e duhur.



- 1 Të ngrihem nga gjumi në orën e caktuar.

- 2 Të kryej shërbimet e higjienës personale.



- 3 Të mos bëhem vonë për në shkollë.



- 4 Të mësoj në orarin e caktuar.



5 Të luaj dhe të argëtohem pas mësimëve.

5 Të fle në orarin e duhur.



Të gjitha këto veprime, unë i kryej sipas orarit ditor që kam përgatitur vetë.

7:00	Çohem nga gjumi dhe bëj gjimnastikë.
7:15	Ha mëngjes dhe përgatitem për në shkollë.
7:30	Shkoj në shkollë.
12:30	Kthehem nga shkolla.
13:00 - 14:00	Ha drekë dhe pushoj.
14:00 - 16:00	Bëj detyrat dhe mësoj.
17:00 - 19:00	Luaj dhe argëtohem.
19:30	Ha darkë dhe shoh televizor.
20:30	Shkoj në shtrat.



DISKUTO NË KLASË

1. Diskuto me shokun ose shoqen e bankës për orarin e veprimeve ditore.
2. Krahasoni së bashku oraret tuaja. Cili/cila nga ju e kryen më mirë orarin e veprimeve ditore?

Plotëso orarin e veprimeve të tua ditore.

Dita ime

Emri im është _____



Unë ngrihem dhe bëj gjimnastikën në orën...



Ha mëngjesin në orën...



Shkoj në shkollë në orën...



Ha drekën në orën...



Bëj mësimet në orën...



Luaj dhe argëtohem në orën...



Ha darkën në orën...



Shkoj të fle në orën...





Më pëlqejnë shumë festat. Në familjen time i festojmë të gjitha. Këto ditë, klasa jonë po bën përgatitje për të festuar ditën e Pavarësisë së vendit tonë. Ajo është dita më e rëndësishme e Kosovës. Unë ndihem shumë krenar për vendin tim.



Për festën e Pavarësisë, së bashku me shokët dhe shoqet e klasës përgatitim vjersha, këngë, flamuj dhe plot zbukurime të tjera.

Për festën e 7 Marsit, ne e zbukurojmë klasën me lule shumë të bukura. Disa prej tyre i përgatitim vetë dhe ia dhurojmë mësueses.



DISKUTO NË KLASË

Pyet shokun ose shoqen e bankës se cila nga festat i pëlqen më shumë. Po ty?

Për festën e **Vitit të Ri**, bashkë me shokët dhe shoqet e klasës përgatitim plot gjëra të bukura. Bëjmë modele kapelesh dhe i ngjyrosim, përgatitim edhe pemën e Vitit të Ri.



Së bashku me shokun ose shoqen e bankës, përgatitni vargje me lule prej letre. Mjetet e punës: letra me ngjyra, gërshërë, vizore, ngjitëse.



Kur bashkëpunojmë, festojmë edhe më bukur

Kur ka festë, të gjithë në klasë kanë nga një detyrë të caktuar për të kryer.

Për t'i kryer sa më shpejt dhe më mirë detyrat tona, punojmë në grupe. Në fillim caktojmë drejtuesin e grupit dhe bëjmë gati mjetet e punës: letër A4 me ngjyra, lapsa të zinj, lapsa me ngjyra, gërsërë, ngjitës, spango.

1 Vizatojmë modelet dhe i presim me gërsërë.



2 Ngjitim me njëra-tjetrën pjesët e modeleve që kemi vizatuar, duke krijuar kështu zbulime të ndryshme.



Në fletët me ngjyra, ne vizatojmë edhe yje me madhësi të ndryshme. I presim ato me gërrshërë dhe formojmë vargje si në figurë. Me vargjet e yjeve zbukurojmë dritaret ose muret e klasës.



Presim edhe flamuj me ngjyra të ndryshme dhe i kalojmë në fije spangoje.



Për festën e Pavarësisë, përgatitim flamuj për të zbukuruar klasën.



JEP MENDIMIN TËND

1. Si u realizua detyra e dhënë nga mësuesja?
2. Çfarë mendimi keni për punën në grup?
3. Si duket klasa në ditë feste? Si ndihesh kur ke ndihmuar në krijimin e një mjedisi festiv?

6.4-5

Përgatitim postera dhe zbulurime për festat

1 Krijo një poster (hamer) për një temë që të pëlqen.

Dita e Tokës

Veprimtaritë gjatë ditës



Lëviz me biçikletë!



Mbill lule!



Mbyll rubinetin!



Mbill pemë!



Hidhi mbetjet në vendin e duhur!



Kurse energjinë!



Riciklo!



Përdor qese të riciklueshme!

V e p r i m t a r i

- 2 Punoni në grup. Vizatoni figurat që ju duhen për posterin.
- 3 Pritini dhe ngjitini në një fletë kartoni.



- 4 Zgjidhni njërin nga modelet e mëposhtme ose krijoni vetë një të tillë.



DISKUTO NË KLASË

1. Diskutoni me njëri-tjetrin për modelet që keni krijuar.
2. A ju pëlqejnë ato?
3. Përshkruaj ndihmesën tënde gjatë punës në grup (pjesëmarrja, përgjegjësia, materialet e përdorura etj.).

Puno modele me plastelinë

- 1 Zgjidh modelin që të pëlqen.
- 2 Puno së bashku me shokun ose shoqen për ta formuar atë.



- 3 Bëni një konkurs në klasë. Kush ka punuar më bukur? Si keni bashkëpunuar me shokun ose shoqen? Zgjidhni punimin më të mirë.

TEST



3

1 Përcakto llojin e profesionit.

8 pikë



2 Përshtkruaj veprimet që po bën djali.

10 pikë

 1	 2	 3	
 4	 5	 6	
 7	 8	 9	 10

Pikë	1-5	6-9	10-14	15-18
Vlerësimi				

Referenca

- Korniza Kurrikulare e Kosovës, Prishtinë, gusht 2016
- Kurrikula Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin fillor të Kosovës, Prishtinë, gusht 2016
- Kurrikula lëndore/programi mësimor Shkathhtësi për jetë, gusht 2018
- Vlerësimi formativ (MASHT/ USAID)
- Udhëzues të ndryshëm për mësimdhënës të klasave fillore
- Rruga e Hulumtimeve, Prishtinë 2008

BURIME NGA INTERNETI:

- <https://www.youtube.com/watch?v=jQ2e0KH5Wrl>
- <https://www.youtube.com/watch?v=dRV7YdygqAg>
- <https://www.pinterest.com/pin/281543706987588/>
- <https://www.youtube.com/watch?v=VorVTs1esLQ>
- <https://www.youtube.com/watch?v=f7Jrp8RlZg4>
- <https://www.youtube.com/watch?v=xOKr462HLc0>
- https://www.pinterest.com/pin/AdAJtH724JZDwO466MywLIBHVHMJ4_ogM9oGJYBqfDupHc72eVuf11U/
- <https://www.pinterest.com/pin/85075880444510638/>
- <https://www.google.al/>
- https://www.pinterest.com/pin/AfiphR8_qLr4XLpvOBC4GoySR-hVukmli626n4E7APMBNI8-IXfW-tg/
- <https://www.dreamstime.com>

Emri: _____

Prit dhe ngjit

I RICIKLUESHËM



I PARICIKLUESHËM



Emri: _____

Të mbajmë pastër mjedisin ku jetojmë!

Situata e parë

Shkruaj ose trego me anë të një vizatimi si ndihmon për të mbajtur pastër shtëpinë.

Situata e dytë

Trego me anë të një vizatimi se çfarë do të doje të bëje në lagjen tënde, që ajri të jetë më i pastër dhe me aromë të këndshme.

Situata e tretë

Çfarë pune do të bësh, për ta mbajtur pastër klasën?

Situata e katërt

Trego me një vizatim punën që do të bësh në oborrin e shkollës për ta mbajtur pastër atë.

Emri: _____

Si mund ta ndihmojmë tokën?



Plotëso:

3

Sende që mund t'i riciklojmë:

2

Sende që mund t'i ripërdorim:

1

Diçka që mund ta ruajmë ose ta kursejmë:

Emri: _____

Objekte që përdoren për higjienën personale

Ngjyros shkronjat për të formuar emrin e objektit sipas shembullit të dhënë.



P U E SH C Q X I R M



S I A G P N U V N



R K I R S Ë H N R I





P I L A S K T N A



F A U B R T Ç Y A

Emri: _____

Ngjyros atletet dhe vendos lidhëset e tyre



Emri: _____

Unë shkoj në shkollë me:



Autobus



Makinë



Biçikletë




Në këmbë

Shkruaj dhe vizato mjetin me të cilin shkon në shkollë?




Emri: _____

Prit dhe formo kubin




Emri: _____

Prit dhe ngjit në vendin e duhur




Emri: _____

Prit dhe vendosi figurat sipas orarit



Emri: _____

Vizato kapelën festive, ngjyrose sipas dëshirës dhe në fund prite



Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.016:37(075.2)

(Lipoveci) Pruthi, Laura

Shkathësi për jetë : për klasën e parë të arsimit
9-vjeçar / Laura Pruthi (Lipoveci). – Prishtinë : Botime
Pegi, 2019. – 76 f. : ilustr. ; 20.7 x 28 cm.

ISBN 978-9951-786-10-2

Lejohet për botim me vendimin e Ministrisë
së Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë,
nr. 419/01-B, të datës 23.08.2019.